

Raport vlerësimi nga terreni

Prej Pilot Njësive Komunale në Komuna me të Drejta të Plota: Shqyrtim i Vitit të Parë

Mars, 2010

***Mohim:** Gjetjet e prezantuara në këtë raport i takojnë periudhës kohore deri në gusht 2009.
Megjithatë, këtu ofrohen edhe rezultatet e zgjedhjeve 2009.*

PËRMBAJTJA

1.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
2.	HYRJE.....	4
3.	PILOT NJËSITË KOMUNALE: FAKTET THEMELORE	4
	3.1 Themelimi dhe qëllimi.....	4
	3.2 Korniza ligjore	5
	3.3 Korniza institucionale	6
4.	PUNA E KOMUNAVE TË REJA.....	6
	4.1 Fushëveprimi dhe kompetencat	6
	4.2 Menaxhimi financiar	8
	4.3 Shtylla legjislative.....	9
	4.4 Dega ekzekutive	10
	4.4.1 Dega ekzekutive: Menaxhimi i burimeve njerëzore.....	11
	4.5 Marrëdhëniet institucionale	12
	4.5.1 Komunat e reja – komuna amë.....	12
	4.5.2 Komunat e reja – Qeveria qendrore	13
	4.5.3 Komunat e reja - marrëdhëniet/asistenca e jashtme	14
	4.6 Zgjedhjet Lokale 2009 në komunat e reja.....	15
5.	PËRFUNDIME	16
6.	REKOMANDIMET	17
7.	SHTOJCAT: HARTA.....	19
	7.1 2009 Rezultatet e zgjedhjeve lokale	19
	7.1.1 Komuna e Hanit të Elezit / Đeneral Janković	19
	7.1.2 Komuna e Junikut / Junik.....	20
	7.1.3 Komuna e Mamuša / Mamushës/ Mamuša	21

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale është instrumenti i parë ligjor i shumë shteteve që ka përcaktuar dhe mbron parimet e autonomisë lokale. Qëllimi i saj është t'i ruajë të drejtat e autoriteteve lokale që janë më të afërta me qytetarët, t'ua japë qytetarëve mundësinë që të marrin pjesë në mënyrë efikase në marrjen e vendimeve që ndikojnë në mjedisin e tyre të përditshëm dhe ta garantojë pavarësinë politike, administrative dhe financiare të autoriteteve lokale.

Në tetor të vitit 2002, z. Michael Steiner, Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) dhe kryesues i Misionit të Kombeve të Bashkuara për Administrim të Përkohshëm në Kosovë (UNMIK), shpalli planin për ta zbatuar edhe më tej frymën e Kartës dhe për ta sjellë qeverinë e Kosovës edhe më afër banorëve në nivel lokal përmes krijimit të njësive të reja komunale të zgjedhura në nivel lokal – disa prej të cilave kishin komunitete të mëdha joshumicë. Si edhe në vende tjera të Ballkanit Perëndimor, objektiva kryesore ishte që të ofrohet një mekanizëm për t'ua mundësuar komuniteteve, posaçërisht atyre joshumicë, që në nivel lokal të kenë kontroll të mjaftueshëm politik mbi shërbimet kyçe komunale. Hapi i parë në këtë proces të reformimit të qeverisë lokale ishte themelimi i pilot njësive komunale, që u paramenduan të shërbejnë si test për krijimin e komunave të reja në zonat me komunitete joshumicë. Pilot njësitë komunale u themeluan në vitin 2005 dhe për tri vite morën gradualisht kompetencat nga të ashtuquajturat komuna amë.¹

Në maj të vitit 2008, Departamenti i Monitorimit i Misionit të OSBE-së në Kosovë (OSBE) publikoi raportin *Pilot njësitë komunale: e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja*, ku vlerësohej progresi i pilot njësive komunale prej themelimit të tyre në gusht të vitit 2005. Duke u bazuar në hulumtimet e OSBE-së dhe raportet gjashtëmujore të vlerësimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, raporti ofroi një vështrim të themelimit, funksionimit dhe sfidave të ardhme të njësive komunale pilot në rrugëtimin e tyre për t'u bërë komuna me të drejta të plota.

Në gusht të vitit 2008, tri pilot njësitë funksionale komunale u kthyen në komuna me të drejta të plota. Ky raport, i përgatitur si nismë e Njësive të OSBE-së në terren që operonin në Komunitat e Reja, vlerëson progresin e komunave të reja gjatë vitit të parë si komuna me të drejta të plota, në periudhën prej gushtit 2008 deri në gusht 2009.

Raporti tregon që tri komunat e reja kanë funksionuar deri tani pa pengesa dhe kanë qenë mjaft të suksesshme në disa fusha. Bartja e kompetencave pothuajse ka përfunduar dhe është bërë rrjedhshëm në të gjitha pilot njësitë e dikurshme komunale. Raportet e tyre me komunat përkatëse amë gjithashtu kanë qenë relativisht pa probleme.

Për më tepër, raporti tregon që raportet mes pilot njësive komunale dhe nivelit qendror kanë qenë të kënaqshme në masë të madhe. Megjithatë, niveli qendror do të duhej të vazhdojë t'ua japë prioritet këtyre komunave kur përgjigjet në kërkesat dhe pyetjet e tyre derisa të mos zhvillohet edhe më tej kapaciteti i tyre. Për këtë qëllim, niveli qendror do të duhej t'i shmanget çfarëdo zvogëlimi buxhetor në lidhje me shërbimin civil të komunës që ndërlidhet me pragun e stafit. Kjo do të jetë e dobishme për kapacitetin e komunave për të punësuar shërbim civil profesional dhe me përvojë.

Një fushë problematike e identifikuar në raport është efikasiteti dhe pavarësia e degës legjislative. Hulumtimi e identifikon kuvendin e komunës dhe komitetet e tij si një nga subjektet kryesore për projektet e ndërtimit të kapaciteteve në të ardhmen për pilot njësitë e dikurshme komunale.

¹ Komuna amë i referohet komunës nga e cila është marrë një numër i zonave kadastrale për ta krijuar pilot njësinë komunale.

2. HYRJJE

Misioni i OSBE-së në Kosovë zhvillon aktivitete për t'i përkrahur parimet e qeverisjes së mirë në të gjitha komunat e Kosovës dhe synon ta vlerësojë respektimin e kornizës ligjore për qeverisje lokale nga ana e komunave në pajtim me parimet e të drejtave të njeriut dhe standardeve të qeverisjes së mirë. Gjithashtu, ai mëton të promovojë një nga parimet kyçe të qeverisjes së mirë, përkatësisht që shërbimet të jenë më afër banorëve.

Synimi i këtij raporti është që të vlerësojë se si kanë funksionuar pilot njësitë komunale prej kur janë kthyer në komuna me të drejta të plota në gusht të vitit 2008. Pas tri vitesh të funksionimit sipas Programit pilot, këto komuna tani funksionojnë pa qenë të udhëzuara drejtpërdrejt nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Ky vlerësim i një viti bazohet në hulumtimet në terren dhe analizën e kujdesshme pasuese nga ana e Njësive në terren të OSBE-së në Han të Elezit / Đeneral Janković, Junik / Junik dhe Mamuša / Mamushë / Mamuša, që u takuan gati rregullisht për ta shqyrtuar punën e komunave përkatëse. Grupi konsideroi që ky raport do të shërbejë si ushtrim me kohë për t'i identifikuar sfidat kryesore, praktikatat më të mira dhe mësimet e mësuara, nga të cilat do të mund të formuloheshin rekomandimet përfundimtare për çfarëdo projekti për reformimin e qeverisjes lokale në të ardhmen.

Si parim themelor i qeverisjes së mirë, reforma e qeverisjes lokale synon ta përkrahë llogaridhënien dhe transparencën, si dhe ta nxisë edhe më tej zbatimin e standardeve të etikës gjatë kryerjes së punëve publike. Bartja e shërbimeve te niveli lokal ua mundëson banorëve që të luajnë një rol më aktiv në marrjen e vendimeve për ofrimin e shërbimeve dhe u ofron një kuptueshmëri më të mirë të çështjeve dhe fakteve që ua mundësojnë atyre që përmes zgjedhjeve lokale ta vlerësojnë me kritikë punën e qeverisë së tyre lokale.

3. PILOT NJËSITË KOMUNALE: FAKTET THEMELORE

Ky kapitull ofron një vështrim të shkurtër të themelimit dhe qëllimit të pilot njësive komunale dhe kornizës së tyre ligjore dhe institucionale.

3.1 Themelimi dhe qëllimi

Në prill të vitit 2004, Këshilli i Sigurimit i KB-ve nxori një Deklaratë Presidenciale me të cilën kërkoi *“qeverisje më efektive lokale përmes bartjes së përgjegjësisë jo të rezervuara qendrore te autoritetet dhe komunitetet lokale në Kosovë.”*² Si përgjigje në këtë, Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) dhe Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) e krijuan Grupin Punues për Qeverisje Lokale (Grupi Punues). Në korrik të vitit 2004, Grupi Punues, i bashkëkryesuar nga përfaqësuesit e IPVQ-ve dhe të UNMIK-ut, në pajtim me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale³, e përgatiti Kornizën për Reformën e Vetëqeverisjes Lokale (Korniza) në Kosovë, që pastaj u aprovua nga IPVQ-të. Korniza parashihte rristrukturimin e disa komunave ekzistuese përmes krijimit të një numri të kufizuar të pilot njësive komunale.⁴

² Kumbesa për Shtyp SC/8082 nga takimi i 4960-të i Këshillit të Sigurimit, i mbajtur më 30 mars 2004.

³ Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, Këshilli i Evropës, Strazburg, 15 tetor 1985.

⁴ Pilot njësitë komunale të Hanit të Elezit / Đeneral Janković, Junikut / Junik dhe Mamuša / Mamushës / Mamuša u themeluan, kurse ato të Gračanica / Graçanicës dhe Parteš / Parteshit nuk u bënë kurrë funksionale për shkak të konsideratave politike.

Implementimi i Kornizës filloi në qershor të vitit 2005 kur PSSP-ja nxori një Urdhëresë Administrative për themelimin e pesë pilot njësive komunale.⁵ Nga ato, dy pilot njësi komunale u parapanë për zonat me shumicë shqiptare, një për zonën me shumicë turke, dhe dy për zonat me shumicë serbe.

Juniku / Junik dhe Hani i Elezit / Đeneral Janković janë zona ku jetojnë kryesisht shqiptarët. Juniku / Junik u themelua nën komunën e Deçanit/Dečane në veriperëndim të Kosovës, duke mbuluar pesë zona kadastrale me përafësisht 9,000 banorë.⁶ Hani i Elezit / Đeneral Janković shtrihet në juglindje të Kosovës, në kufi me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, dhe u themelua nën komunën e Kaçanikut / Kačanik. Në njëmbëdhjetë zonat e saj kadastrale jetojnë rreth 10,000 banorë.⁷

Pilot njësia komunale e Mamuša / Mamushës / Mamuša u krijua nën komunën e Prizrenit dhe aty jetojnë rreth 5,500 banorë, shumica e të cilëve janë turq. Mamuša / Mamusha / Mamuša përfshin vetëm një zonë kadastrale.⁸

Pilot njësitë komunale të Gračanica / Graçanicës dhe Parteš / Parteshit, të planifikuara për zonat me shumicë serbe nuk u bënë kurrë funksionale. Pilot njësia komunale e Gračanica / Graçanicës do të mbulonte pesë zona kadastrale, kurse ajo e Parteš / Parteshit tri zona kadastrale.

3.2 Korniza ligjore

Themelimi dhe veprimi i pilot njësive komunale përcaktohet me Urdhëresën Administrative nr. 2005/11 për Projekte pilot që zbaton Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, ashtu si është ndryshuar me Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/13. Neni 4.1 i Urdhëresës Administrative nr. 2005/11 thotë: *“Fushëveprimi i përgjegjësive dhe i pushtetit, i strukturës dhe i procedurave të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive komunale pilot do të bëhet përshtatshëm siç parashihet në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/45[...].”*

Hapësira territoriale e pilot njësive komunale⁹ dhe përbërja e kuvendeve të përkohshme të pilot njësive komunale¹⁰ caktohen me Vendime Ekzekutive që i nxjerr PSSP-ja. Derisa hapësira territoriale është caktuar në të pesë pilot njësive komunale, kuvendet e përkohshme u emëruan me sukses dhe u bënë funksionale vetëm në Han të Elezit / Đeneral Janković, Mamuša / Mamushë / Mamuša dhe Junik / Junik.

⁵ Urdhëresa Administrative nr. 2005/11 për Pilot projektet që zbaton Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë.

⁶ Profili i Junikut / Junik, i ofruar nga Ekipi i terrenit OSBE-së në Junik / Junik.

⁷ Profili i Hanit të Elezit / Đeneral Janković, i ofruar nga Ekipi i terrenit i OSBE-së në Han të Elezit / Đeneral Janković.

⁸ Profili i Mamuša / Mamushës / Mamuša, i ofruar nga Njësia komunale e OSBE-së në Mamuša / Mamushë / Mamuša.

⁹ Vendimi Ekzekutiv nr. 2005/17 mbi hapësirën territoriale të Pilot njësisë komunale të Junikut / Junik; Vendimi Ekzekutiv nr. 2005/18 mbi hapësirën territoriale të Pilot njësisë komunale të Parteš / Parteshit; Vendimi Ekzekutiv nr. 2005/19 mbi hapësirën territoriale të Pilot njësisë komunale të Hanit të Elezit / Đeneral Janković; Vendimi Ekzekutiv nr. 2005/20 mbi hapësirën territoriale të Pilot njësisë komunale të Gračanica / Graçanicës; dhe Vendimi Ekzekutiv nr. 2005/21 mbi hapësirën territoriale të Pilot njësisë komunale të Mamuša / Mamushës / Mamuša.

¹⁰ Vendimi Ekzekutiv nr. 2005/27 mbi Kuvendin e përkohshëm të Pilot njësisë komunale të Junikut / Junik; Vendimi Ekzekutiv nr. 2005/28 mbi Kuvendin e përkohshëm të Pilot njësisë komunale të Hanit të Elezit / Đeneral Janković; dhe Vendimi Ekzekutiv nr. 2005/29 mbi Kuvendin e përkohshëm të Pilot njësisë komunale të Mamuša / Mamushës / Mamuša.

Rregullat e organizimit, funksionimit dhe strukturimit të pilot njësive komunale caktohen me Urdhëresën Administrative nr. 2006/2 mbi organizimin dhe strukturën e brendshme të Pilot njësive komunale¹¹ të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.

3.3 Korniza institucionale

Pilot njësitë komunale u themeluan në vitin 2005, në kohën kur Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/45 për vetëqeverisjen e komunave në Kosovë ishte kornizë e zbatueshme ligjore në vend. Përkundër aprovimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2007/30 që ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/45 në tetor të vitit 2007 nga ana e shumicës së komunave të Kosovës, pilot njësitë komunale vazhduan ta zbatojnë Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/45 deri në kohën kur u kthyen në komuna me të drejta të plota në qershor të vitit 2008, kur në fuqi hyri korniza e re ligjore. Tre muaj më vonë, përmes një korrespondence tjetër me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, komunave u dhanë afate strikte kohore për ta zbatuar Ligjin në fuqi për Vetëqeverisje Lokale, siç ishin duke bërë shumica e komunave tjera të Kosovës prej qershorit të vitit 2008.¹²

Struktura dhe kompetencat e degëve legjislative dhe ekzekutive të komunave përcaktohen me Ligjin në fuqi për Vetëqeverisje Lokale. Sipas këtij ligji, kuvendi i komunës është organi më lartë legjislativ i komunës dhe përgjegjësitë kryesore të tij janë që të përpilojë dhe miratojë statutin e komunës, rregulloren e punës së komunës dhe rregulloret komunale. Gjatë periudhës së vlerësimit në këtë raport, përbërja e kuvendeve komunale në tri komunat e reja rrodhi nga rezultati i zgjedhjeve në nëntor të vitit 2002 në komunat përkatëse amë. Partitë politike propozuan kandidatë në bazë të përqindjes që e fituan në komunat amë, dhe ata pastaj u miratuan nga ana e PSSP-së. Pas zgjedhjeve të nëntorit të vitit 2002, mandati i tri kuvendeve të përkohshme u zgjat sipas rekomandimit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal përmes Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/13 për ndryshimin dhe plotësimin e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2005/11.

Në zgjedhjet e nëntorit të vitit 2009, banorët e tri pilot njësive të dikurshme komunale votuan për herë të parë për t'i zgjedhur kryetarët e tyre të komunës dhe anëtarët e kuvendit të komunës (shih rezultatet në Shtojcën 7.1).

4. PUNA E KOMUNAVE TË REJA

Ky kapitull e vlerëson punën e komunave prej kur janë kthyer prej pilot njësive komunale në komuna me të drejta të plota, apo komuna të reja, në gusht të vitit 2008. Degët legjislative dhe ekzekutive kanë përgjegjësi sipas Ligjit në fuqi për Vetëqeverisjen Lokale dhe legjislacionit plotësues të tij.

4.1 Fushëveprimi dhe kompetencat

Ligji në fuqi për Vetëqeverisje lokale i referohet kompetencave vetanake (neni 17) dhe të deleguara (neni 18) të komunës. Në pilot proces, komunat e reja filluan t'i marrin disa nga këto kompetenca nga komunat përkatëse amë të Deçanit / Deçane, Kaçanikut / Kačanik dhe Prizrenit. Ato kanë qenë kryesisht të suksesshme në bartjen e kompetencave nga komunat e tyre amë (administrimin e arsimit,

¹¹ Udhëzimi Administrativ nr. 2006/2 i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për strukturën dhe organizimin e brendshëm të Pilot njësive komunale.

¹² Në letren e datës 18 shtator 2008 u përshkruan shprehimisht obligimet e komunave për të ndërmarrë masa në pajtim me Ligjin në fuqi për Vetëqeverisje Lokale. Letra dha autorizimin që kryetarët e kuvendeve të përkohshme të kthehen në kryetarë të komunave përkatëse, dhe sqaroi që ata nuk kanë të drejtë të jenë anëtarë të kuvendit të komunës së tyre përkatëse, e as të kuvendit të komunës të komunës së tyre amë. Për më tepër, kuvendet e komunës do ta mbanin numrin e njëjtë të anëtarëve deri në zgjedhjet e ardhshme lokale, dhe kishin 60 ditë kohë për ta miratuar statutin e tyre komunal, dhe 15 ditë kohë për ta miratuar rregulloren e tyre të punës.

menaxhimin e financave, shërbimet shëndetësore dhe urbanizmin), si dhe disa tjera nga niveli qendror.¹³

Bartja e kompetencave nga komunat amë te komunat e reja ka kaluar mjaft rrjedhshëm. Pilot njësitë e dikurshme komunale tani kanë fuqi të plotë dhe ekskluzive mbi çdo “kompetencë vetanake” dhe “kompetencë të deleguar”, me përjashtim të regjistrimit civil në Han të Elezit / Dëneral Janković dhe Junik / Junik.¹⁴ Zhvillim që vlen të përmendet është hapja e zyrës komunale për regjistrim civil në Mamuša / Mamushë / Mamuša në maj të vitit 2009, që ua mundësoi banorëve të saj të pajisen me dokumente personale (letërnjoftime, pasaporta etj) pa pasur nevojë të udhëtojnë në Prizren për këtë qëllim.

Kapaciteti i dobët i Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Planifikim Urban është ende sfida kryesore me të cilën duhet të përballen komunat e reja. Për këtë arsye, Agjencia Kadastrale e Kosovës mbajti një numër të trajnimeve¹⁵ gjatë prillit të vitit 2009 për t'i ndërtuar kapacitetet e këtyre drejtorive. Në anën tjetër, Hani i Elezit / Dëneral Janković është ende në pritje të bartjes së disa të dhënave kadastrale¹⁶ nga komuna amë, që po shkakton vonesa të mëtejshme në ofrimin e shërbimeve kadastrale dhe të urbanizmit për banorët. Ndihma dhe këshillimi shtesë sipas nevojës i ofrohet Hanit të Elezit / Dëneral Janković nga ana e Kaçanikut / Kačanik, kurse Mamuša / Mamushës / Mamuša nga ana e Rahovecit / Orahovac fqinj.¹⁷

Në prill të vitit 2009, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ua barti të gjitha komunave të Kosovës kompetencat në fushën e shërbimeve sociale. Komunat e reja, ndryshe nga komunat e tyre amë, nuk kanë qendra për punë sociale të themeluara brenda kufijve të tyre. Sipas udhëzimit të Ministrisë, nga dy anëtarë të personelit të komunave amë u transferuan në komuna të reja për ta plotësuar mungesën e këtyre qendrave.

Këta anëtarë të personelit qëndrojnë në zyrat komunale për punë sociale, bashkë me personelin nga drejtoritë komunale për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.¹⁸ Themelimi i Qendrave të tyre të pavarura për punë sociale është ende në pritje të ndarjes së fondeve shtesë. Pa marrë parasysh këtë, personeli i emëruar ka demonstruar kapacitetin për t'i kryer detyrat përkundër mungesës së kushteve të nevojshme nëpër hapësirat që shpesh i shfrytëzon bashkërisht me drejtoritë tjera komunale.

¹³ Përmes një grupi ndërministror të krijuar për t'u marrë më çështjet e reformës së qeverisjes lokale, qeveria planifikon t'i bartë kompetencat në fushat në vijim: Mirëqenia sociale; Ndërmarrjet publike lokale; Kultura, Rinia, Sporti; Regjistrimi i biznesit PSSP (Kompetencë e deleguar); Shëndetësia primare; Arsimi në shkolla; Prona komunale; Banimi publik; Shënimet kadastrale (Kompetencë e deleguar); Mbrojtja e pyjeve (Kompetencë e deleguar); Huamarrja komunale; Regjistrimi i votuesve (Kompetencë e deleguar).

¹⁴ Jo për shkak të mungesës së vullnetit politik apo ndonjë problemi të lidhshëm komunal, por më shumë për mungesë të kapacitetit të komunës në lidhje me hapësirë zyrash dhe personel.

¹⁵ Agjencia Kadastrale e Kosovës organizoi trajnime në komunat përkatëse për personelin e tyre në lidhje me procedurat dhe sistemin e regjistrimit të të dhënave.

¹⁶ Deri në gusht të vitit 2009, Hani i Elezit / Dëneral Janković kishte pranuar shënimet grafike, por ende nuk kishte pranuar të dhënat tekstuale nga Kaçaniku / Kačanik.

¹⁷ Një zgjidhje pragmatike për ta rritur kapacitetin e Mamuša / Mamushës / Mamuša është gjetur me komunën fqinje të Rahovecit / Orahovac, që nuk e përfshin komunën e dikurshme amë të Prizrenit. Prej shtatorit të vitit 2009 deri në mes të vitit 2010, të gjitha matjet dhe dokumentet kadastrale në lidhje me Mamuša / Mamushën / Mamuša do të lëshohen në komunën e Rahovecit/Orahovac, që gjithashtu do të ofrojë trajnime për punonjësit e drejtorisë për kadastër të Mamuša / Mamushës / Mamuša.

¹⁸ Me përjashtim të Mamuša / Mamushës / Mamuša, ku dy anëtarët e personelit udhëtojnë prej Prizrenit në Mamuša / Mamushë / Mamuša gjatë javës, siç përcaktohet me Memorandumin e Mirëkuptimit mes dy komunave.

4.2 Menaxhimi financiar

Në fund të vitit 2008 janë shuar pozitat e administratorëve të përkohshëm financiarë¹⁹, duke i dhënë kompetenca të plota tri pilot njësi komonale të mëparshme për operacionet e tyre përmes drejtorëve të tyre për buxhet dhe financa, të cilët përkritazi kishin të drejtë të menaxhonin financat e tyre në mënyrë të pavarur.²⁰ Që nga atëherë, komunat e reja kanë hartuar në mënyrë të pavarur dhe të suksesshme propozimet për buxhet, duke i shtuar operacionet e tyre dhe respektuar kufijtë buxhetore²¹ në pajtim me udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Propozimet buxhetore për vitin 2010 përmbajnë plane për shtimin e shërbimeve të ofruara nga pilot njësitë komonale të mëparshme, me ngritjen më të madhe të propozuar nga Mamuša / Mamusha / Mamuša. Komuna e re ka propozuar një rritje prej 64 për qind²², duke i ndarë 32 për qind nga buxheti i saj për investime kapitale.²³ Junik/Juniku dhe Hani i Elezit / Đeneral Janković kanë suficit të jashtëzakonshëm të buxhetit nga vitet e kaluara, ndryshe nga Mamuša / Mamushë / Mamuša, e cila e ka shpenzuar buxhetin si dhe shumat e mëdha të donacioneve të pranuar nga donatorët e jashtëm. Këto dy komuna janë të vetë-qëndrueshme dhe që të dyja këto kanë arritur të zhvillojnë projektet e infrastrukturës dhe kanë propozuar zgjidhje kreative për tejkalimin e problemeve lidhur me kufizimet financiare. Hani i Elezit / Đeneral Janković ka pasur suficit të buxhetit prej 2 për qind në përfundim të vitit 2008; propozimi i buxhetit për vitin 2010²⁴ është 1.24 milionë €, një rritje prej 7.25 për qind nga buxheti i miratuar i vitit 2009.²⁵ Komuna është duke planifikuar një rritje të lehtë të fondeve në dispozicion për investime kapitale, nga 27 për qind në këtë vit në 28 për qind vitin e ardhshëm. Komuna e Junikut / Junik, pas operimit me suficitin e buxhetit prej 16 për qind, ose 122,000 €, në fund të vitit 2008,²⁶ e ka përshtatur buxhetin për gjysmën e dytë të vitit 2009 për financimin e projekteve të komunitetit, duke përfshirë ndërtimin e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtjen e rrugëve dhe shtratit të lumenjve si dhe përmirësimin e ujitjes së tokave. Buxheti i propozuar për vitin 2010 prej 1 milionë € ishte një ngritje për 1.6 për qind.

Komunat e reja kanë filluar grumbullimin e tatimit në pronë që nga janari i vitit 2007 dhe që atëherë i kanë shfrytëzuar të hyrat për të i plotësuar buxhetet tyre përkatëse. Hani i Elezit / Đeneral Janković ka grumbulluar me sukses 52,000 € në vitin 2008 dhe deri në fund të gushtit 2009 ka grumbulluar 45,000

¹⁹ Nga viti 2007, Ministria për Financa dhe Ekonomi i ka ndarë grante operative pilot njësi komonale drejtpërsëdrejti nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, por këto të fundit janë lejuar ta menaxhojnë shpenzimin e granteve operative përmes Administratorit të Përkohshëm Financiar, të emëruar nga Ministria. Administratorët e Përkohshëm Financiarë janë përgjegjës për marrjen e vendimeve përfundimtare për gjithë shpenzimin e buxheteve të Pilot Njësi Komonale.

²⁰ Kryetarët e komunave nuk kanë qenë në dijeni për këtë informatë dhe në janar të vitit 2009 ata e morën përgjegjësinë për menaxhimin financiar.

²¹ Në fillim të vitit buxhetor 2009, është kërkuar nga të gjitha komunat e Kosovës që ta zvogëlojnë buxhetin për mallra dhe shërbime për 10 % për vitin 2009, gjë që iu përmbajtën pilot njësitë komonale, përkundër ngritjes së tyre në kapacitete. (Sipas vërejtjes së dërguar nga Ministria për Financa dhe Ekonomi, në mes të muajit tetor 2008.)

²² Buxheti për vitin 2008 ka qenë 515,000 € dhe për vitin 2009 ka qenë 737,000 €. Buxheti i propozuar për vitin 2010 është 1,209,000€, një rritje prej 64 % nga buxheti i vitit 2009. Komuna ka shënuar rritje prej 43 % në buxhetin e vitit 2009, prej buxhetit të vitit 2008 që ishte 515,000 €.

²³ 391,000€ janë planifikuar për investime kapitale në buxhetin e propozuar për vitin 2010.

²⁴ Siç e ka paraqitur komuna para 40 qytetarëve në dëgjimin e dytë për buxhet, në gusht të vitit 2009.

²⁵ Buxheti i miratuar për vitin 2009 është 1.15 milionë €; pas shqyrtimit gjashtë-mujor të buxhetit dhe bërjes së ndryshimeve të nevojshme për përfshirjen e të hyrave prej 14,000 € nga të hyrat vetanake të komunës.

²⁶ Në vitin fiskal 2008 Juniku / Junik ka shpenzuar vetëm 84.1 % prej 770,000 € nga buxheti i tij vjetor. Këto kursime ndodhën pjesërisht për shkak të projekteve të vonuara dhe që duheshin përfunduar dhe paguar në vitin 2009, siç janë ndërtimi i trotuareve si dhe procesi i gjatë dhe relativisht i ngadalshëm i bërjes së Junikut / Junik komunë me të drejta të plota, që nënkupton rekrutimin e personelit, krijimin e zyrave dhe drejtorive të reja, zgjerimin e sektorëve ekzistues si dhe jetësimin e shërbimeve të reja.

€. Mamuša / Mamushë / Mamuša ka arritur shumën në 14,000 € nga të hyrat e tatimit mbi pronë, krahasuar me Junikun / Junik që arrin shumën në 35,000 €.

Si Hani i Elezit / Đeneral Janković ashtu edhe Juniku / Junik kanë mbajtur dëgjimet buxhetore duke kryer me sukses dhe transparencë planifikimin financiar, ndërsa kuvendi komunal i Mamuša / Mamushës / Mamuša i ka dorëzuar rishikimin gjashtë mujor të buxhetit 2010-2012 drejtpërsëdrejti Ministrisë pa mbajtur asnjë dëgjim buxhetor.

Komunat e Kosovës duhet t'i nënshtrohen auditimit fiskal në mënyrë që *“të sigurohet efikasitet më i madh operacional, një disiplinë më e madhe fiskale si dhe respektim i rregullave nga njësitë e sektorit publik, duke kërkuar që veprimtaritë, shënimet si dhe sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të të gjitha subjekteve të sektorit publik t'i nënshtrohen auditimit të brendshëm sistematik dhe gjithëpërfshirës”*.²⁷ Që nga tetori i vitit 2009, vetëm Juniku / Junik ka rekrutuar një auditor të brendshëm, i cili do t'i përgjigjej drejtpërsëdrejti kryetarit të komunës. Zyrtarët komunalë të Hanit të Elezit / Đeneral Janković kanë pohuar që nuk kanë pasur mundësi të themelojnë njësinë për auditim të brendshëm për shkak të kufizimit të numrit të personelit. Mamuša / Mamusha / Mamuša ka paraparë një njësi për auditim të brendshëm në buxhetin e vitit 2009, por kjo mbetet që të realizohet. Kjo komunë, gjithashtu ka përfshirë edhe themelimin e njësisë për auditim të brendshëm në buxhetin e saj për vitin 2010.

4.3 Shtylla legislative

Nga gushti i vitit 2008 deri në gusht 2009, seksionet legislative të komunave të reja kanë filluar të funksionojnë në mënyrë të pavarur. Ato kanë hartuar dhe miratuar me sukses statutet komunale, të gjitha në pajtim me modelet e statuteve themelore, të nxjerra nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe ligjin e zbatueshëm mbi vetëqeverisjen lokale. Që të tri komunat e reja i zgjedhën kryesuesit për udhëheqjen e punës së kuvendit komunal dhe organeve të tij përbërëse. Në Junik / Junik dhe Mamuša / Mamushë / Mamuša, kryesuesit e zgjedhur janë femra. Përveç shtatë rregulloreve²⁸ komunale në Junik / Junik, katër në Mamuša / Mamushë / Mamuša²⁹ dhe shtatë në Han të Elezit / Đeneral Janković, janë miratuar edhe Rregulloret e Punës.³⁰

Debatet të cilat zhvillohen në kuvendin komunal mund të japin një indikacion të fortë të organit legjislativ që funksionon në mënyrë të pavarur nga dega ekzekutive. I tillë është, për shembull, rastin në Hanin e Elezit / Đeneral Janković ku opozita³¹ e kundërshton rregullisht udhëheqësinë komunale sa i përket përputhshmërisë me legjislacionin e zbatueshëm. Në një instancë të caktuar, opozita ka kërkuar nga niveli qendror që ta shqyrtojë zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit, që ka rezultuar me përsëritje të votimit si dhe me shfuqizim të të gjitha vendimeve të marra nën udhëheqjen e kontestuar të kryesuesit.³²

²⁷ Neni 1 i Ligjit mbi auditimin e brendshëm të shpallur me Rregulloren 2007/19 të UNMIK-ut. Neni 4.1 i Ligjit kërkon që secili subjekt i sektorit publik t'i nënshtrohet – së paku një herë në vit – një auditimi të brendshëm gjithëpërfshirës të kryer nga a) një njësi e auditimit të brendshëm, ose b) një auditor i brendshëm (në rast se njësi e auditimit të brendshëm nuk është themeluar).

²⁸ Rregullorja e Punës dhe Rregulloret mbi Transparencën; Përdorimi i Gjuhëve; Inspektimi i shpenzimeve dhe tatimeve; Taksat dhe tarifat komunale; Shfrytëzimi i hapësirës publike për qëllime komerciale; Lejet e punës; dhe ndërtimi.

²⁹ Rregullorja e Punës dhe Rregulloret për tatimin mbi pronë për 2009; Përdorimi i Gjuhëve; Transparenca dhe tri projekt rregulloret mbi procedurat për licencimin e vendeve të punës dhe për tatimin mbi pronën e paluajtshme.

³⁰ Rregullorja e Punës dhe Rregulloret mbi tatimin në pronë; Taksat, tarifat dhe gjobat; Shkolla e mesme; Shkolla fillore; Transparenca; Transporti rrugor; Orari i punës dhe aktivitetet në punë.

³¹ Para zgjedhjeve të 2009, PDK –ja kishte 7 ulëse, LDK-ja 6 ulëse, AAK-ja 1 ulëse dhe 1 të pavarur.

³² Udhëheqësi i grupit parlamentar të LDK-së i ka dorëzuar një kërkesë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për ta shqyrtuar vlefshmërinë e zgjedhjes së kryesuesit, kur kryetari i kuvendit komunal (tani kryetari i komunës) ka marrë pjesë në votim. Pas dy muajve, ministria është përgjigjur, duke kërkuar përsëritjen e votimit dhe anulimin e të gjitha vendimeve të marra në dy seancat e mbajtura nga kryesuesi kontestues.

Opozita e Mamuša / Mamushës / Mamuša³³ rrallëherë e ka kundërshtuar udhëheqjen komunale dhe kryetarin e komunës, për shkak të dominimit të Partisë Demokratike Turke të Kosovës (KDTP) dhe suksesin e saj³⁴ në këtë zonë. Kuvendi komunal në Junik / Junik është pllakosur nga mospjesëmarrja e partive opozitare.³⁵

Një indikacion tjetër i pavarësisë së degës legislative është ndarja e komisioneve të kuvendit komunal në funksionimin e komisioneve të përhershme³⁶ dhe të atyre jo të detyrueshme³⁷. Puna e komisioneve në Mamuša / Mamushë / Mamuša është e dobët: komisioni për politikë dhe financa mban takime të parregullta dhe jozyrtare, derisa komisioni për komunitete është takuar vetëm dy herë që nga fillimi i vitit 2008. Në Junik / Junik, përveç këshillit komunal për siguri në bashkësi, vetëm komisioni për komunitete është takuar vetëm një herë gjatë periudhës për të cilën raportohej. Në anën tjetër, në Han të Elezit / Đeneral Janković, janë themeluar komisionet për politikë dhe financa dhe ato për komunitete dhe ato kanë mbajtur takime në periudha të rregullta kohore³⁸. Veç kësaj, kuvendi komunal tanimë ka ndërmarrë hapa për themelimin e tri komisioneve konsultative.³⁹

4.4 Dega ekzekutive

Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/45, kryeshefi ekzekutiv ka shërbyer si sekretar i kuvendit, kryesues i bordit të drejtorëve dhe shef i personelit komunal. Siç është përmendur edhe më parë, pilot njësitë komunale nuk e kanë zbatuar Rregulloren e UNMIK-ut 2007/30 që e bën plotësim-ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/45. Me zbatimin e Ligjit të ri mbi vetëqeverisjen lokale, kryetari drejtpërdrejtë i zgjedhur, e udhëheq qeverinë dhe administratën komunale dhe është përgjegjës për administrimin financiar të komunës dhe zbatimin e vendimeve të kuvendit komunal. Ligji i zbatueshëm për vetëqeverisjen lokale i jep kryetarit të komunës më shumë përgjegjësi, si mbikëqyrja e funksioneve administrative, financiare dhe operacionale të komunës, duke e bërë kështu ende më të qartë ndarjen ndërmjet degës ekzekutive dhe legislative të komunës.

³³ Opozita është formuar nga një ulëse e pavarur (rom) dhe një ulëse e lirë e PDK-së. Pozita ka qenë e lirë që kur deputeti i mëparshëm i PDK është emëruar si zëvendës kryetar për komunitete. Kryetari i nëndegës së PDK-së i ka bërë kërkesë Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal për zëvendësim më 14 tetor 2008, por kuvendi komunal akoma nuk ka marrë ndonjë përgjigje.

³⁴ Zhvillimi i pandërprerë i Mamuša / Mamushës / Mamuša dhe zhvillimi infrastrukturor është ndihmuar nga lidhjet e ngushta të kryetarit të komunës me institucionet turke.

³⁵ Pas bojkotimit tre vjeçar, anëtari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK-së) ka dhënë betimin për të iu bashkuar kuvendit komunal në dhjetor të vitit 2008. Vendimi i tij është ndikuar nga përmirësimi i statusit të komunës dhe domethënia e përgjithshme që pjesëmarrja në kuvendin e komunës me të drejta të plota, si kundërshtim ndaj kuvendit të përkohshëm, do të shpaguej më shumë. Gjashtë anëtarë të AAK-së janë ende duke e bojkotuar kuvendin komunal dhe të gjitha mbledhjet komunale, duke i vënë në pyetje numrin e ulëseve të dhëna atyre nga PSSP-ja. Kjo parti pohon që ka pasur të drejtë për përfaqësim më të fuqishëm pas zgjedhjeve të nëntorit 2007 për shkak të dominimit të kësaj partie në komunën amë të Deçanit / Deçane. (LDK-ja ka tetë ulëse, AAK-ja gjashtë ulëse dhe PDK-ja një ulëse.)

³⁶ Sipas Ligjit të zbatueshëm mbi vetëqeverisjen, dy komisionet e përhershme janë ai për politikë dhe financa dhe komisioni për komunitete.

³⁷ Në pajtim me nenin 51 të Ligjit të zbatueshëm mbi vetëqeverisjen, që kërkon themelimin e komisioneve të përhershme për t'i kontribuar punës së kuvendit komunal.

³⁸ Komisioni për politikë e financa takohet para çdo takimi të asamblesë komunale dhe komisioni për komunitete ka hartuar një plan të punës dhe është takuar katër herë gjatë periudhës për të cilën raportohej, përkundër pranisë së vogël të komunitetit jo-shumicë boshnjak të Kosovës, i cili ka kohë të gjatë që është integruar plotësisht në komunitetin shumicë shqiptar të Kosovës.

³⁹ Në seancën e asamblesë komunale të mbajtur më 27 gusht 2009, deputetët kanë miratuar përbërjen e trupit përzgjedhës për 15 anëtarët e tri komisioneve konsultative të planifikuara. Në korrik dhe gusht të vitit 2009, komuna ka bërë dy ftesa për ofertë për shprehjen e interesit për pjesëmarrje në këto komisione.

Sipas udhëzimeve të dhëna nga qeveria e Kosovës (në letrën e sipërpërmendur, të lëshuar nga Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal, të datës 18 shtator 2008), kryetari i kuvendit komunal të do të ushtrojë detyrën e kryetarit të kuvendit deri në zgjedhjet e radhës dhe nuk ka të drejtë, që në të njëjtën kohë, të jetë edhe deputet i kuvendit komunal. Në Han të Elezit / Đeneral Janković, kryetari i kuvendit komunal të përkohshëm ka ngurruar të marrë përgjegjësinë e postit të kryetarit të kuvendit pas shndërrimit të pilot njësisë komunale në komunë derisa ka pranuar udhëzime zyrtare nga niveli qendror. Pasiguria e tij është shkaktuar nga frika që opozita do ta shihte këtë veprim si përpjekje për zgjerimin e kompetencave institucionale nga ana e tij. Kjo gjë potencialisht do të kishte efekt të kundërt në perceptimin e asaj, që dega legjislative dhe ekzekutive veprojnë në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra. Në Mamuşa / Mamushë / Mamuşa dhe Junik / Junik nuk kishte nevojë për mbështetje nga niveli qendror, duke e marrë parasysh mungesën e ndonjë kundërshtimi ndaj autoritetit të kryetarit të komunës.⁴⁰

Si ish-profesionist mediash, kryetari i Mamuşa / Mamushës / Mamuşa⁴¹ bën përpjekje të konsiderueshme në ngritjen e profilit të komunës, duke theksuar rregullisht synimin e tij për zhvillimin dhe shndërrimin e Mamushës / Mamuşa / Mamuşa jo vetëm në qendër bujqësore, por gjithashtu edhe në atraksion turistik të Kosovës. Arritjet më të dukshme të tij në këtë komunë kryesisht turke, lidhen me përmirësimet në infrastrukturën komunale dhe qasjen në shërbime komunale. Ai ka përqendruar përpjekjet e tija entuziaste në tërheqjen e fondeve për projekte të veçanta si në burimet nga Kosova ashtu edhe nga vendet tjetra dhe deri më tani, ai ia ka dalë të nënshkruajë marrëveshje binjakëzimi me pesë komuna jashtë Kosovës, kryesisht në Turqi.

4.4.1 Dega ekzekutive: Menaxhimi i burimeve njerëzore

Gjatë fazës provuese, komunat amë ishin përgjegjëse për pjesën dërmuese të shërbimeve, që i ofroheshin qytetarëve derisa u bë kalimi i tyre gradual në pilot komuna. Tani, duke funksionuar si komuna me të drejta të plota, pilot komunat e mëparshme kanë përgjegjësi të larta kundruall qytetarëve të tyre. Ndonëse, shërbimi civil është zgjeruar në tri komuna të reja gjatë periudhës shqyrtuese njëvjeçare në mënyrë që komunat t'i administrojnë shërbimet e përmirësuara për qytetarët, por sigurisht që ata ende nuk kanë kuadro të mjaftueshme.

Ministria për Ekonomi dhe Financa i ka liru komnat e reja nga kufizimet për ngritjen e pagave dhe pagesave për vitin 2010, që janë detyrim për komunat tjera;⁴² zyrtarët komunal shpresojnë që ky lirim pasqyron gatishmërinë e nivelit qendror për të shqyrtuar edhe njëherë kufizimet në numrin e personelit komunal, të cilat nuk janë përcaktuar për komunat e reja. Pas shtimit të numrit të personelit komunal nga 22 në 43 pjesëtarë të personelit (nëntë femra) në 2009, Mamuşa / Mamusha / Mamuşa ka propozuar një ngritje të 15 pozitave për vitin e ardhshëm, që është në pritje të miratimit nga ministria për buxhetin e propozuar për vitin 2010. Hani i Elezit / Đeneral Janković ka shtuar numrin e personelit komunal nga 20 në 2008 (një femër) në 40 në 2009 (katër femra) me plan që të bëhet një shtim tjetër prej 15-20 në 2010. Juniku / Junik ka shtuar numrin prej 18 (dy femra) në 2008 në 47 (tetë femra) në 2009, me planet e tyre për personelin komunal për vitin 2010, që ka mbetur për t'u vendosur që nga tetori 2009.

Përkundër shtimit të shërbimeve civile së voni, këto komuna bëjnë pohime të ngjashme si komunat tjera të Kosovës, që niveli qendror ka vënë kufizime të ashpra dhe joreale për numrin e personelit, duke i detyruar kështu shërbyesit civilë të mbajnë pozita të shumta, në mënyrë që të ofrojnë të gjitha shërbimet komunale. Në Mamuşa / Mamushë / Mamuşa, një shërbyes civil mban postin e zyrtarit të njësisë për të

⁴⁰ Sipas ekipeve komunale në terren të OSBE-së, në Junik / Junik dhe Mamuşa / Mamushë / Mamuşa kjo letër vetëm se ka shtuar mbështetjen e mëtutjeshme të kryetarëve të komunave, ndërsa ekipi për qeverisje lokale në Han të Elezit / Đeneral Janković ka raportuar që kryetari i komunës nuk do bënte asnjë veprim pa mbështetjen e nivelit qendror, nga frika prej ndonjë reagimi të ashpër nga ana e opozitës.

⁴¹ Kryetari i mëparshëm i komunës ka qenë njëri prej themeluesve të revistës në gjuhën turke “Yarin” dhe Radio Televizionit të Prishtinës/Priştina.

⁴² Qarkorja buxhetore 2010/01e Ministrisë për Financa dhe Ekonomi.

drejttat e njeriut, zyrtarit komunal për barazi gjinore dhe zyrtarit për integritet evropiane, por nuk duket që t'i kryejë këto funksione në mënyrë të duhur.⁴³ Në anën tjetër, kufizimet në numrin e personelit mund të përdoren si arsye për mos-plotësimin e pozitave kyçe e të detyrueshme, të cilat po që se plotësohen, mund të shërbejnë si kundërpeshë ndaj autoritetit të disa zyrtarëve komunal. Për shembull, në Han të Elezit / Deneral Janković, nuk është punësuar asnjë zyrtar për shef të personelit. Në vend të kësaj, drejtori i administratës së përgjithshme i emëruar nga kryetari i komunës ushtron detyrën e shefit të personelit, e cila parashihet të jetë pozita më e lartë që mund ta mbajë një shërbyes civil në komunë. Kryetari i komunës përmend kufizimet në numrin e personelit dhe në buxhet, si arsye për mos rregullimin e situatës.⁴⁴ Ekipi komunal i OSBE-së në terren e vlerëson që kjo është mënyra përmes së cilës kryetari i komunës mund të ketë ndikim mbi çështjet e personelit.

Rekrutimi i personelit teknik dhe të specializuar, veçanërisht në fushën e shëndetësisë, teknologjisë informative, planifikimit urbanistik dhe financave paraqet sfida për komunat e reja dhe ndikon në cilësinë e ofrimit të shërbimeve. Për shembull, Hani i Elezit / Deneral Janković ka bërë përpjekje që të zëvendësojë dy mjekë të mëhershëm në qendrën e shëndetit pas largimit të tyre, meqë nuk ka qenë e mundur të gjenden aplikantë të kualifikuar në këtë komunë. Individët e kualifikuar nga qytetet më të mëdha dekurajohen nga çmimi i vajtje-ardhjes në këto komuna më të izoluar dhe komunat nuk mund të kompenzojnë shpenzimet e udhëtimit për shkak të kufizimeve qendrore. Për pozitat tjera të specializuara, siç janë në drejtorinë e kadastrit, urbanizmit dhe mbrojtjes së ambientit, komunat janë detyruar që t'i rishpallin konkurset disa herë për vende të lira të punës, në mënyrë që t'i identifikojnë kandidatët, të cilët i përmbushnin kualifikimet minimale.

4.5 Marrëdhëniet institucionale

Marrëdhëniet, të cilat komunat i kanë pasur me aktorët e ndryshëm gjatë viteve të kaluara, kanë pasur ndikim në procesin e tranzicionit prej pilot njësisë komunale në atë të komunës me drejta të plota. Kjo pjesë vë në pah ndikimin e secilit prej këtyre raporteve në përparimin e këtyre komunave.

4.5.1 Komunitat e reja – komuna amë

Siç është vlerësuar më parë nga raporti i fundit i OSBE-së për pilot njësitë komunale, përbërja politike e asambleve sipas raportit ka rol qendror në formësimin e marrëdhënieve ndërmjet pilot njësisë komunale dhe komunave amë, duke përcaktuar kështu se sa rrjedhshëm mund të barten kompetencat. Si Mamuša / Mamusha / Mamuša ashtu edhe Hani i Elezit / Deneral Janković janë udhëhequr nga partia e njëjtë si komuna e tyre amë,⁴⁵ duke e bërë procesin e tranzicionit më të lehtë se sa pilot njësitë komunale tjera të Junikut / Junik. Për shembull, PDK-ja duke qenë parti në pushtet në Han të Elezit / Deneral Janković dhe në Kaçanik / Kačanik (komuna amë) i ka dhënë 20 anëtarëve të rinj të personelit në të parën mundësinë të tregohen para kolegëve në të dytën. Lidhjet e ngushta ndërmjet personelit të të dy komunave u mundëson atyre që kanë më pak përvojë, që të kërkojnë ndihmë nga homologët e tyre më përvojë.

Rastet e vetme të pazgjidhura ndërmjet komunave të reja dhe atyre amë ndërlidhen me kontestet që dalin nga transferimi i personelit në komuna të reja. Si në Mamuša / Mamushë / Mamuša ashtu edhe në Han të Elezit / Deneral Janković, ka pasur vonesa në transferimin e personelit arsimor nga lista e pagave

⁴³ Siç parashihet në Udhëzimin Administrativ 2005/08 mbi Përcaktimin e kompetencave dhe përshkrimin e detyrave të punës së zyrtarëve për barazi gjinore nëpër komuna dhe Udhëzimi Administrativ 2008/02 mbi ndryshim-plotësimin e Udhëzimit Administrativ 2007/08 për themelimin e Njësive për të Drejtat e Njeriut në komuna.

⁴⁴ Shqyrtimi gjashtë mujor i buxhetit është dorëzuar në nivelin qendror më 27 maj, 2009.

⁴⁵ Mamuša / Mamusha / Mamuša udhëhiqet nga Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), që së bashku me PDK-në përbëjnë koalicionin shumicë në Prizren / Prizren, dhe Hani i Elezit / Deneral Janković me Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) gjithashtu mban shumicën në Kaçanik / Kačanik .

e komunës amë tek komunat e reja. Kërkesat për rregullimin e kësaj gjendjeje drejtuar Ministrisë së Arsimit, Shkencës e Teknologjisë dhe Ministrisë për Financa dhe Ekonomi ende nuk janë trajtuar,⁴⁶ gjë që tregon më shumë çështje të prapambetura me ministritë se sa konteste serioze ndërmjet komunave.

Marrëdhëniet jo të mira ndërmjet komunës së Deçanit/Deçane dhe Junikut/Junik kanë rezultuar në vonesa për transferimin e kompetencave. Mungesa e përkrahjes së banorëve në fshatrat Voksh / Vokša, Sllup / Slup dhe Rastavicë / Rastavica në lidhje me vendosjen e kufijve kadastrorë ka shtyrë ata t'i drejtohen qeverisë me një kërkesë. Vetëm në qershor 2008, me hyrjen në fuqi të ligjit të zbatueshëm mbi Kufijtë Administrativë Komunalë, fshatrat iu kthyen zonës kadastrorë të Deçanit / Deçane. Përfundimisht, rezultatet e zgjedhjeve më 2007, të cilat nxitën bojkotin e kuvendit komunal nga AAK, kanë rezultuar në legjislacion të dobët në Junik/Junik.

4.5.2 Komunat e reja – Qeveria qendrore

Në shumicën e rasteve⁴⁷ gjatë vitit të kaluar, Qeveria e Kosovës ka trajtuar komunat e reja si të gjitha komunat tjera – ajo i mban ato të përgjegjshme për respektimin e legjislacionit të zbatueshëm si të gjitha komunat tjera. Zyrtarët komunalë në Han të Elezit / Đeneral Janković dhe Junik / Junik raportojnë se marrëdhëniet e tyre me nivelin qendror kanë qenë bashkëpunuese dhe të ngushta. Në komunën e Mamushës/ Mamuša/ Mamuša, aftësitë personale të Kryetarit të Komunës dhe kontaktet e ngushta me nivelin qendror kanë rezultuar në një marrëdhënie njëlloj të ngushtë ndërmjet komunës dhe qeverisë.⁴⁸ Përderisa komunave tjera u jepen grante apo fonde për projekte bazuar në propozime të zhvilluara apo respektimin komunal të ligjit, marrëdhënia e Kryetarit të Komunës duket të luajë një rol në aftësinë e komunës për të fituar projekte nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.⁴⁹

Këto komuna, për dallim prej komunave tjerave në Kosovë, janë vonuar në respektimin e legjislacionit të zbatueshëm për përdorimin e gjuhëve. Ato shpesh pohojnë që prania e ulët e komuniteteve jo-shumicë dhe stafi i mbingarkuar komunal dekurajon ata nga respektimi i ligjit.⁵⁰

⁴⁶ Ndonëse është pranuar kërkesa e Mamusa / Mamushës / Mamuša e bërë në nëntor të vitit 2008, drejtuar Ministrisë për Financa dhe Ekonomi për transferimin e personelit të shkollës së mesme “Gjon Buzuku” dhe fondet monetare nga Prizreni / Prizren në Mamuša / Mamushë / Mamuša, Prizreni / Prizren është përgjegjës që të dërgojë kërkesën për buxhet dhe strukturën organizative. Deri më sot, nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga ana e Prizrenit / Prizren, gjë që ka rezultuar me vonesa në pagesën e pagave të mësimdhënësve në shkolla. Drejtori i Arsimit në Mamuša / Mamushë / Mamuša planifikon të takojë homologun e tij në Prizren / Prizren për zgjidhjen e kësaj çështjeje para fillimit të vitit të ri shkollor. Kaçaniku / Kačanik dhe Hani i Elezit / Đeneral Janković kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi më 2 shtator, 2008 për transferimin e dy mësimdhënësve të Laqit / Ljaç nga njëri buxhet komunal në tjetrin, gjë e cila do të realizohet që nga 1 shtatori, me kopjet që do t'i dërgohen Ministrisë së Arsimit, Shkencës e Teknologji dhe Ministrisë për Financa dhe Ekonomi. Kërkesa e dytë është dërguar nga drejtorët e drejtorive për arsim dhe financa në Han të Elezit / Đeneral Janković ministrive përkatëse më 12 shkurt 2009 për realizimin e këtij transferimi, por deri më tani nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Ministria ende nuk e ka bërë transferimin zyrtar dhe mësimdhënësit janë paguar përmes linjës buxhetore të kuvendit komunal.

⁴⁷ Përveç Qarkores Buxhetore 2010/01, e cila përjashton komunat e reja nga kufizimi i fondeve buxhetore për pagesat dhe rrogat.

⁴⁸ Raporti i OSBE mbi aktet komunale nxjerr si përfundim se megjithëse ka bashkëpunim ndërmjet nivelit lokal dhe qendror gjatë procesit të rishikimit të akteve komunale, nuk ka një sistem të caktuar apo praktikë të komunikimit dhe mënyra se si zyrtarët komunal komunikojnë me nivelin qendror përgjatë procesit dallon nga një komunë në një tjetër. Marrëdhëniet ndërmjet Qeverisë Qendrore dhe Lokale – Aktet Komunale, Misioni i OSBE në Kosovë, Tetor 2009.

⁴⁹ Projekti i drenazhit për shtratin e lumit dhe zgjerimin e parkut të qytetit në qershor 2009 ka kushtuar përafërsisht 200.000 euro. Kryetari i Komunës ka shpallur dy projekte të parapara për vitin 2010 për ndërtimin e një linje të re elektrike (1.2 milion euro) dhe për ndërtimin e një fabrike për pastrimin e ujërave të zeza (50.000 euro), të cilat pritet të financohen nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

⁵⁰ Në Ligjin mbi Përdorimin e Gjuhëve, të shpallur nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2006/51, gjuha shqipe dhe serbe janë të përcaktuara si gjuhë zyrtare me status të barabartë në Kosovë dhe me të drejta të barabarta për përdorimin e tyre në të gjitha institucionet e Kosovës.

Komuna e Hanit të Elezit / Đeneral Janković rrallë herë siguron përkthim të dokumenteve, shpalljeve apo takimeve në gjuhën serbe, duke e trajtuar atë më shumë si gjuhë në përdorim zyrtar⁵¹ se sa një gjuhë zyrtare. Banorët e Hanit të Elezit / Đeneral Janković kanë shprehur pakënaqësinë e tyre me emërtimin serb të komunës, Đeneral Janković, për shumë vite; megjithatë në vend të kërkesës drejtuar qeverisë për ndërrimin e emrit zyrtar, komuna thjesht ka aplikuar në regjistrin e saj civil vulat me emërtimin Hani i Elezit / ‘Hani i Elezit’,⁵² të cilat janë lëshuar nga Ministria e Administratës Publike. Anëtarët i vetëm rom në kuvendin komunal të Mamushës/ Mamuša / Mamuša shpesh nuk merr ndonjë përkthim nga gjuha turke në atë shqipe.⁵³ Disa nga shenjat në Mamushë / Mamuša / Mamuša dhe Junik / Junik nuk janë në pajtim me rregulloret komunale mbi përdorimin e gjuhëve, të miratuara nga vetë kuvendet komunale. Pohohet që Kryetari i Komunës së Mamushës / Mamuša / Mamuša ka marrë një vërejtje nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në lidhje me shenjat por pa ndonjë rezultat.

4.5.3 Komunitat e reja - marrëdhëniet/asistenca e jashtme

Organizatave ndërkombëtare ofrojnë përkrahje edhe për komunitat e reja. OSBE ka pasur ekipe komunale në secilën pilot njësi komunale që nga viti 2006; pas shndërrimit në komuna me funksion të plotë, këto ekipe kanë vazhduar të monitorojnë dhe këshillojnë mbi respektimin e parimeve të drejtave të njeriut dhe standardeve të qeverisjes së mirë. Përveç kësaj, komunitat e reja janë përkrahur nga KFOR-i, UN-Habitat, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Komisioni Evropian.

Hani i Elezit / Đeneral Janković dhe Mamusha / Mamuša / Mamuša secila janë shpërblyer me grante stimuluese prej 45,000\$⁵⁴ për tejkalimin e pragut nga mbledhja e taksave mbi pronën. Projekti dy-vjeçar i Komisionit Evropian i quajtur “Përkrahje për Qeverinë Lokale/EULOG” përpiqet të merret me funksionimin dhe transparencën e departamenteve komunale, bashkëpunimin ndër-komunal, inspektoratin, planet zhvillimore komunale dhe zbatimin efektiv të ligjit të zbatueshëm mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe menaxhimin financiar të komunave. UN-Habitat-i është duke punuar për të ndërtuar kapacitetet e komunave në fushën e planifikimit urban dhe hapësinor.

Komunitat e Hanit të Elezit / Đeneral Janković⁵⁵ dhe Junikut / Junik⁵⁶ secila ka tërhequr asistencën e organizatave të huaja jo-qeveritare, por jo deri në atë masë sa komuna e Mamushës / Mamuša / Mamuša. Marrëdhëniet e afërta të komunës së Mamushës /Mamuša / Mamuša me institucionet dhe organizatat në Turqi kanë tërhequr investime të konsiderueshme në këtë komunë të vogël, të ndihmuar nga promovimi i komunës nga ana e Kryetarit gjatë vizitave të tij në Turqi. Në këtë mënyrë komuna ka siguruar financimin për disa projekte.⁵⁷ Komuna e Mamushës / Mamuša / Mamuša është

⁵¹ Siç është përcaktuar nga Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve: “Në komunitat e banuara nga një bashkësi, gjuha amtare e të cilës nuk është gjuhë zyrtare dhe e cila përbën së paku 5 për qind të popullsisë së përgjithshme të asaj komune, gjuha e asaj bashkësie do të ketë statusin e gjuhës zyrtare në atë komunë dhe do përdoret barabartë me gjuhët zyrtare.”

⁵² Emërtimi Hani i Elezit / ‘Hani i Elezit’ shkel ligjin e zbatueshëm mbi Kufijtë Administrativ Komunal dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2000/43 mbi Numrin, Emrat dhe Kufijtë e Komunave siç është ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 2004/36.

⁵³ Nëse një përfaqësues nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është i pranishëm, përkthyesi komunal përkthen për zyrtarin e nivelit qendror sesa për anëtarin rom të kuvendit komunal.

⁵⁴ Dollarë Amerikan.

⁵⁵ OJQ nga Irlanda Veriore “Kosova Support Group [Grupi Përkrahës i Kosovës]” ka dhuruar 15.000 euro për pajisjet teknike të Brigadës së Zjarrfikësve dhe Shpëtimt të Komunës së Hanit të Elezit / Đeneral Janković.

⁵⁶ OJQ Suedeze “Cultural Heritage without Borders [Trashëgimia Kulturore pa Kufij]” ka dhuruar 37.000 euro për restaurimin e kullës nga shekulli i shtatëmbëdhjetë “Ali Hoxha” në qendër të Junikut / Junik; pronari i kullës është pajtuar që kulla të jepet për shfrytëzim publik për një periudhë dhjetë-vjeçare pas restaurimit.

⁵⁷ Këto përfshijnë ndërtimin e ndërtesës së re komunale dhe të shkollës fillore, pajisjen e qendrës mjekësore me mjete shëndetësore dhe një donacion për librarinë e sapa hapur.

binjakëzuar me pesë komuna të huaja, përfshirë katër në Turqi. Një tregues i mbështetjes së komunës në ndihmat e huaja është pasqyruar në propozimin për buxhet të vitit 2010, i cili cakton edhe 9.8 milion euro për projektet kapitale. Megjithatë financimi për këto projekte parashihet të bazohet më tepër nga donatorët e jashtëm tek të cilët komuna ka ose do të dorëzoj 18 projekte të ndryshme, sesa nga burimet e të ardhurave vetanake.⁵⁸ Ndonëse kjo është një e arritur në vete, në praktikë kjo e vendos komunën në një situatë të rrallë. Komuna e Mamushës / Mamuša / Mamuša është në gjendje të shmangë çfarëdo rënie ekonomike, e cila ndikon në nivelin qendror dhe mund të vazhdojë procesin e shpejtë të zhvillimit infrastrukturor.

4.6 Zgjedhjet Lokale 2009 në komunat e reja

Në zgjedhjet lokale të mbajtura në nëntor 2009, qytetarët e tri komunave të Hanit të Elezit / Đeneral Janković, Junikut / Junik, dhe Mamushës / Mamuša / Mamuša kanë votuar për herë të parë në zonat e tyre zgjedhore. Këto zgjedhje do të shërbejnë si një test i mirëfilltë për të tri komunat. Udhëheqja e tyre është mbajtur përgjegjëse para zgjedhësve dhe komunat kanë qenë përgjegjëse për zbatimin e suksesshëm të operacionit të planifikimit dhe mbarëvajtjes së zgjedhjeve.

Në aspektin logjistik, organizimi i zgjedhjeve në komunat e reja për herë të parë është koordinuar nga zyrtarët komunalë për zgjedhje. Për të siguruar gjitha përgatitjet dhe për të mundësuar një ditë të qetë të zgjedhjeve, zyrtarët komunalë për zgjedhje nga komunat amë kanë ofruar ndihmën e tyre në proces për komunat e reja, duke marrë parasysh administrimin e mëhershëm nga ana e tyre të këtyre territoreve në zgjedhjet e kaluara. Komunat kanë respektuar gjitha afatet zgjedhore⁵⁹ dhe nuk janë paraparë probleme të mëdha për shkak se këto komuna mbulojnë territore të vogla, me më pak qendra votimi në krahasim me komunat e tjera të Kosovës.

Si në të gjitha komunat tjera, lista e votuesve është nxjerrë nga Regjistri i Gjendjes Civile, që do të thotë se ndryshimet në regjistrin civil janë pasqyruar në listën e votuesve. Kjo po ashtu nënkupton që nëse votuesit kanë harruar të informojnë regjistrin civil, në rast të ndërrimit të adresës së vendbanimit siç edhe duhet të bëjnë⁶⁰, ata janë caktuar në qendrat e votimit të cilat nuk përputhen me vendbanimin e tyre. Për të korrigjuar këto mospërputhje dhe pasaktësitë e tjera në listën e votuesve Komisioni Qendror Zgjedhor ka nxitur votuesit që gjatë Periudhës së Shërbimit për Votues, që është organizuar prej 1 deri më 15 shtator 2009, të azhurnojnë vendbanimet e tyre në Qendrat Komunale të Regjistrimit dhe të konfirmojnë apo ndryshojnë lokacionin e qendrës së votimit tek komisionet komunale të zgjedhjeve.

Në pajtim me nenin 39 të ligjit të zbatueshëm mbi Vetëqeverisjen Lokale, kuvendet komunale në Han të Elezit / Đeneral Janković, Junik / Junik, dhe Mamushë/ Mamuša / Mamuša kanë nga 15 anëtarë pasi që popullata e tyre është nën 10.000 banorë. Kuvendet komunale në Kaçanik/Kaçanik dhe Deçan/Deçane janë ulur nga 31 në 27 anëtarë, duke marrë parasysh zvogëlimin në numrin e popullatës pas krijimit të komunave të reja; kurse kuvendi komunal i Prizrenit do të ketë 41 anëtarë.

Shumëçka ishte në lojë për zgjedhjet e 15 nëntorit – për herë të parë udhëheqja e tri komunave të reja është testuar para elektoratit të tyre dhe votuesit janë përgjigjur me pjesëmarrje pak më të lartë sesa mesatarja në nivel të Kosovës që ka qenë 44.7 përqind.⁶¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka raportuar për një pjesëmarrje prej 65.1 për qind në Mamushë/Mamuša/ Mamuša, që është pjesëmarrja më e lartë në të gjithë Kosovën, 56.7 për qind në Han të Elezit / Đeneral Janković dhe 45.7 për qind në

⁵⁸ Këto fonde priten, por ende nuk janë të garantuara.

⁵⁹ Komisionet komunale të zgjedhjeve janë krijuar në Han të Elezit / Đeneral Janković dhe Junik / Junik më 06 Korrik 2009 dhe Mamushë/Mamuša / Mamuša më 30 Korrik 2009.

⁶⁰ Sipas Nenit 5 të Ligjit mbi Vendbanimin dhe Vendqëndrimin të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2008/14.

⁶¹ Sipas rezultateve zyrtare të shpallura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Junik / Junik. Këto shifra tregojnë se banorët e komunave të reja i janë përgjigjur kësaj faze të procesit të reformave të pushtetit lokal për të zbatuar vlerat e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe për pjesëmarrje më të madhe në proceset e vendimmarrjes në nivel lokal.

5. PËRFUNDIME

Përderisa komunat vazhdojnë të fitojnë përvojën në miratimin e rregulloreve të tyre komunale, përmirësimin e infrastrukturës dhe ofrimin e shërbimeve për banorët, ato duhet edhe më tutje të zhvillojnë kapacitetet e tyre për t'u marrë me sfida më të mëdha. Ekipet e terrenit të OSBE-së në Han të Elezit / Đeneral Janković, Junik / Junik dhe Mamushë/Mamuşa /Mamuşa vlerësojnë punën e përgjithshme të komunave të reja si të kënaqshme: ato kanë bërë një përparim të konsiderueshëm për një periudhë të shkurtë kohore, por ende ka hapësirë për përmirësime. Më konkretisht, përparim është shënuar në fushat në vijim: transferim të kompetencave nga komunat amë, menaxhim financiar dhe degët ekzekutive. Përmirësimet në zbatimin e legjislacionit të zbatueshëm, fuqizimin e degëve legjislative, përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe në menaxhimin e burimeve njerëzore janë të mirëseardhura.

Komunat e reja kanë shënuar përparim të konsiderueshëm në lidhje me transferimin e kompetencave. Komunat kanë qenë plotësisht të afta për të marrë përsipër sfidat e përgjegjësive të reja dhe të vazhdojnë zhvillimin e tyre profesional nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve dhe trajnimeve të ofruara nga agjencitë e Kosovës, ministritë përkatëse dhe organizatat ndërkombëtare. Edhe në rastet kur personeli i duhur, pajisjet apo edhe mjetet tjera ende nuk janë transferuar, komunat nuk kanë pasur problem për të gjetur zgjidhje të realizueshme për të mirëmbajtur administrimin e shërbimeve komunale për banorët.

Në fushën e menaxhimit financiar, puna e komunave të reja ka përmbushur standardin. Hani i Elezit / Đeneral Janković dhe Juniku / Junik kanë kryer operacione me një suficit të vogël buxhetor në 2008 dhe aftësia e komunës së Mamushës/Mamuşa /Mamuşa për të tërhequr donatorë ka ndihmuar këtë komunë të vogël për të ndërtuar infrastrukturën e saj. Mirëpo komunave duhet t'iu tërhiqet vëmendja dhe duhet të udhëzohen nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave për të respektuar transparencën financiare dhe llogaridhënien duke respektuar ligjet procedurale.

Në Mamushë/ Mamuşa/Mamuşa, raportet e ekzekutivit (kryetarit të komunës) brenda dhe jashtë Kosovës ndihmojnë në tërheqjen e donatorëve për projektet komunale; megjithatë ky pushtet duhet të balancohet me një kuvend komunal aktiv dhe të shëndoshë. Ndonëse arritjet më të shënuara janë të lidhura me zhvillimin e infrastrukturës së komunës, nëse kapaciteti i administratës komunale nuk zhvillohet barabartë, çfarëdo ndryshimi në udhëheqje mund të rrezikojë punën dhe si pasojë kualitetin e shërbimeve komunale për banorët.

Vetëm në komunën e Hanit të Elezit / Đeneral Janković ekziston një baraspeshë e tillë, meqenëse kuvendi komunal ka arritur të nxisë administratën e tij të respektojë legjislacionin e zbatueshëm, duke miratuar legjislacionin e tij në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse. Mungesa e shumëllojshmërisë politike në Mamushë / Mamuşa / Mamuşa dhe marrëdhëniet e trazuar të komunës së Junikut / Junik me komunën amë të Deçanit / Dečane, megjithatë kanë vështirësuar zhvillimin e degëve të tyre legjislative.

Komunat pohojnë se kufizimet e tanishme për personelin detyrojnë udhëheqjen komunale të shpërndajnë një numër të pozitave mbi një shërbim civil veçse të mbingarkuar dhe të papërvojë. Pavarësisht vullnetit të komunave për të gjetur zgjidhje ndaj kufizimeve për punësim të personelit, kualiteti i shërbimeve mund të pësojë nëse komunat vazhdojnë të ballafaqohen me probleme në rekrutimin e personelit profesional në sektorët e arsimit, kadastrit dhe të shëndetësisë.

Komuna e Mamushës / Mamuša / Mamuša është duke u promovuar si një model për reformën e qeverisjes lokale sa i përket dhënies së shanseve të barabarta komuniteteve jo-shumicë për pjesëmarrje në administrimin e pushtetit lokal. Megjithatë të tre komunat e reja kanë përparësitë e tyre të cilat duhet të përdoren si shembuj të praktikave më të mira për projektet e ardhshme për reformën e qeverisjes lokale. Ekipet e terrenit në Han të Elezit / Dëneral Janković, Junik / Junik dhe Mamushë / Mamuša / Mamuša kanë vlerësuar komunën e Junikut / Junik si shembull të praktikave më të mira në lidhje me pjesëmarrjen e banorëve në krijimin e komunës së re,⁶² komunën e Mamushës / Mamuša / Mamuša në lidhje me tërheqjen e donatorëve dhe komunën e Hanit të Elezit / Dëneral Janković për transparencë dhe kuvend komunal funksional dhe profesional.

6. REKOMANDIMET

Niveli lokal:

- a. T'i përmbahet legjislacionit të zbatueshëm, posaçërisht kornizës procedurale, duke përfshirë mbrojtjen e plotë dhe promovimin e të drejtave të njeriut (përfshirë edhe respektimin për përdorimin e gjuhëve).
- b. Të nxitet bashkëpunimin ndër-komunal veçanërisht për shkak të shërbimit civil dhe buxhetit të kufizuar në komunat e reja (për shembull, për zjarrfikje, kadastrë, arsim).
- c. Kuvendet komunale duhet të funksionojnë në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse – me përfshirjen e komisioneve të përhershme dhe konsultative. Pas zgjedhjeve të nëntorit 2009, kuvendet e reja duhet të kenë qasje aktive për të:
 - Organizuar takime publike dhe dëgjime për buxhet,
 - krijuar komisionet e obligueshme dhe jo të obligueshme me terma të qarta të referencës, dhe
 - ushtruar funksionin e tyre mbikëqyrës mbi ekzekutivin.

Niveli qendror:

Të përforcojë kapacitetin e qeverive lokale para vazhdimit të transferimit të plotë të kompetencave (Karta Evropiane mbi Vetëqeverisjen Lokale).

- a. Të ofrojë udhëzime për komunat e reja për krijimin e politikave në fushat e përgjegjësisë.
- b. Të caktojë si prioritet të veçantë përgjigjen ndaj kërkesave dhe pyetjeve nga ish pilot njësitë komunale.
- c. Të mbikëqyrë procesin e rekrutimit të shërbimit civil komunal dhe të lehtësojë tërheqjen e kandidatëve të kualifikuar në fushat e kadastrit/urbanizmit, arsimit, financave dhe shëndetësisë, për shembull duke lejuar shpenzimet e udhëtimit të kompensohen nga komunat.
- d. Të promovojë praktikat më të mira të projektit të pilot njësite komunale: përveç promovimit të komunës së Mamushës / Mamuša / Mamuša si model të decentralizimit, të theksohen edhe sukseset e dy komunave tjera të reja, duke përfshirë edhe të metat e tyre.

Bashkësia ndërkombëtare:

- a. Të vazhdojë ofrimi i asistencës teknike për komunat në mënyrë që ato t'i përmbahen legjislacionit të zbatueshëm.

⁶² Duke përdorur si shembull banorët e tre fshatrave, Voksh / Vokša, Sllup / Slup dhe Rastavicë / Rastavica, të cilët i kanë drejtuar një kërkesë qeverisë në lidhje me ndarjen kadastrale.

- b. Të vazhdojë të nxisë kuvendet komunale gjithëpërfshirëse dhe përgjegjëse duke përkrahur komisionet konsultative dhe fuqizimin e shoqërisë civile lokale.

7. SHTOJCAT: HARTA

7.1 2009 Rezultatet e zgjedhjeve lokale

7.1.1 Komuna e Hanit të Elezit / Đeneral Janković

Zgjedhjet për kryetar komune

Raundi i parë

	Vota	Përqindje
Rufki Suma (kandidat i pavarur)	1,886	44.29 %
Mehmet Ballashi (PDK)	1,553	36.47 %
Musafer Dernjani (LDK)	598	14.04 %
Menduh Vlasi (AAK)	221	5.19 %
Gjithsej vota të vlefshme	4,258	
Numri i personave me të drejtë vote	7,683	
Pjesëmarrja në zgjedhje	4,357 (56.71 %)	

Balotazhi

	Vota	Përqindje
Rufki Suma (kandidat i pavarur)	2,417	53.13 %
Mehmet Ballashi (PDK)	2,132	46.87 %
Gjithsej vota të vlefshme	4,549	
Numri i personave me të drejtë vote	7,683	
Pjesëmarrja në zgjedhje	4,592 (59.77 %)	

Zgjedhjet për kuvend komunal

	Vota	Përqindje	Numri i ulëseve
LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës	1,498	38.77 %	6
PKD – Partia Demokratike e Kosovës	1,459	37.76 %	6
AAK – Aleance për Ardhmërinë e Kosovës	907	23.47 %	3
Gjithsej vota të vlefshme	3,864		
Numri i personave me të drejtë vote	7,683		
Pjesëmarrja në zgjedhje	4,248 (56.71 %)		

7.1.2 Komuna e Junikut / Junik

Zgjedhjet për kryetar komune

Raundi i parë

	Vota	Përqindje
Agron Kuçi (AAK)	1,109	49.64 %
Tahir Isufaj (LDK)	730	32.68 %
Shpejtim Gacaferi (LDD)	239	10.70 %
Niman Tofaj (PDK)	133	5.95 %
Ali Kasumi (AKR)	23	1.03 %
Gjithsej vota të vlefshme	2,234	
Numri i personave me të drejtë vote	4,962	
Pjesëmarrja në zgjedhje	2,269 (45.73 %)	

Balotazhi

	Vota	Përqindje
Agron Kuçi (AAK)	1,268	56.76 %
Tahir Isufaj (LDK)	966	43.24 %
Gjithsej vota të vlefshme	2,234	
Numri i personave me të drejtë vote	4,962	
Pjesëmarrja në zgjedhje	2,249 (45.32 %)	

Zgjedhjet për kuvend komunal

	Vota	Përqindje	Numri i ulëseve
AAK – Aleance për Ardhmërinë e Kosovës	892	43.49 %	7
LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës	708	34.52 %	5
LDD – Lidhja Demokratike e Dardanisë	242	11.80 %	2
PKD – Partia Demokratike e Kosovës	170	8.29 %	1
AKR – Aleanca Kosova e Re	39	1.90 %	0
Gjithsej vota të vlefshme	2,051		
Numri i personave me të drejtë vote	4,962		
Pjesëmarrja në zgjedhje	2,219 (45.72 %)		

7.1.3 Komuna e Mamuša / Mamushës/ Mamuša

Zgjedhjet për kryetar komune

Raundi i parë

	Vota	Përqindje
Arif Bütüç (KDTP)	1,441	80.10 %
Mehmet Mazrek (AKR)	217	12.06 %
Berzat Morina (PDK)	141	7.84 %
Gjithsej vota të vlefshme	1,799	
Numri i personave me të drejtë vote	2,835	
Pjesëmarrja në zgjedhje	1,848 (65.19 %)	

Zgjedhjet për kuvend komunal

	Vota	Përqindje	Numri i ulëseve
KDTP – Kosova Demokratik Türk Partisi	1,134	68.85 %	11
AKR – Aleanca Kosova e Re	254	15.42 %	2
PKD – Partia Demokratike e Kosovës	151	9.17 %	1
Sami Taç	108	6.56 %	1
Gjithsej vota të vlefshme	1,647		
Numri i personave me të drejtë vote	2,835		
Pjesëmarrja në zgjedhje	1,846 (65.11 %)		